



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:233095

Datë: 24.07.2024

Numri i dokumentit: 05974983

Ac.nr.9239/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Besnik Bislimaj dhe Adnan Konushevc, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësve H.F dhe V.F nga fshati Pasomë, Komuna e Vushtrrisë, të cilët i përfaqëson K.B – P., avokate nga Vushtrria, kundër të paditurve Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë, Komunës së Vushtrrisë, I.J nga fshati Sllatinë, Vushtrri, të cilin e përfaqëson N.A nga Vushtrria, N.J të cilin e përfaqëson D.I, avokate nga Vushtrria dhe N.J.1 që të dytë nga fshati Sllatinë Vushtrri, lidhur me dorëzimin faktik të paluajtshmërisë, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurit N.J, e ushtruar përmes përfaqësuesit të përkohshëm dhe ankesën e të paditurve I.J dhe N.J.1, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, C.nr.725/20, i datës 12.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurit N.J e ushtruar përmes përfaqësueses së përkohshme D.I, avokate në Vushtrri dhe ankesa e të paditurve I. dhe N.J.1, që të dy nga fshati Sllatinë, Vushtrri, ndërsa aktgjykimi Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, C.nr.725/20, i datës 12.10.2021, në pikën I, II dhe IV , PRISHET dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

II. Pika V e dispozitivit të aktgjykimit për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë së paditësve mbetet e pa shqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.725/20, i datës 12.10.2021, ka vendosur si në vijim:

“I. AROVOHET kërkesëpadia e paditësve H.F dhe V.F nga fshati Pasomë, Komuna e Vushtrrisë, kundër të paditurve I.J, N.J dhe N.J.1, nga fshati Sllatinë, Vushtrri, me të cilën ka kërkuar lirimin - dorëzimin faktik të paluajtshmërisë, pjesën e parcelën kadastrale K-... Z.K Sllatinë, Vushtrri, e

cila evidentohet në emër të paditësve - bashkëpronarëve H.F dhe V.F, me sipërfaqe prej 913 m² dhe atë me dimensione nga pika 3 deri në pikën 2 në drejtim veri - lindje (338.1.25 cm), nga pika 3 deri tek pika 4 në gjatësi prej 182,16 m dhe gjerësi në anën perëndimore 5.57 m, si e bazuar, ashtu që:

II. DETYROHEN të paditurit I.J, N.J dhe N.J.1, nga fshati Sllatinë, Vushtrri, që paditësve H.F dhe V.F, të ua bëjnë lirim dhe dorëzimin faktik të paluajtshmërisë, respektivisht të pjesës së parcelën kadastrale K-... Z.K Sllatinë, Vushtrri, e evidentuar në emër të paditësve - bashkëpronarëve H.F dhe V.F, me sipërfaqe prej 913 m² dhe atë me dimensione nga pika 3 deri në pikën 2 në drejtim veri - lindje (338.1.25 cm), nga pika 3 deri tek pika 4 në gjatësi prej 182,16 m dhe gjerësi në anën perëndimore 5.57 m.

IV. DETYROHEN të paditurit I.J, N.J dhe N.J.1 që në mënyrë solidare, paditësve të u'a paguajnë shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në lartësi të përgjithshme prej 1904.34 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

V. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësve H.F dhe V.F nga fshati Pasomë, Komuna e Vushtrrisë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Prishtinë dhe Komuna e Vushtrrisë, që të bëj bartjen në teren të koordinatave zyrtare të parcelës kadastrale nr.225 Z.K ..., sipas koordinatave nr.1: ... me ..., nr.2:... me ..., nr.3:... me ..., nr.4:... me ... dhe nr.5:... me ... si dhe kërkesëpadia me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Vushtrrisë që pas zbatimit të koordinatave të lartcekura në teren, paditësve të u'a vej në posedim dhe shfrytëzim paluajtshmerinë duke e fut në RDPP dhe paditësit të pajisen me Certifikatë të pronësisë dhe skicën e planit me pjesën grafike, si e pa bazuar, për shkak të mungesës së legjitimacionit pasiv të të paditurave.”

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të paraparë ligjor ankesë kanë parashtruar:

I padituri N.J, përmes përfaqësueses së përkohshme për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë si të bazuar ankesën, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta prish dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim apo aktgjykimin ta prishë dhe ta hedhë poshtë padinë apo aktgjykimi të ndryshohet.

Të paditurit I.J dhe N.J.1 për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë si të bazuar ankesën, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta prish dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim apo aktgjykimin ta prishë dhe ta hedhë poshtë padinë apo aktgjykimi të ndryshohet.

Përgjigje në ankesë kanë parashtruar paditësit përmes të autorizuarës së tyre, me propozim që ankesat e të paditurve të refuzohen të pabazuara ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

-Ankesat janë të themelta.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësi H.F përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar padi me datën 02.09.2016, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se paditësi në bazë të vendimit mbi ndarjen e tokës nga masa komasative është pronar i parcelës kadastrale me nr.225, me kulturë bujqësore e klasës së III në sipërfaqe prej 2699 m², e evidentuar sipas fletëtreguesit nr.59, Zona Kadastrale ..., dhe sipërfaqen e tokës përafërsisht 500 m², që nuk e shfrytëzon ti kthehet në posedim dhe shfrytëzim, më konkretisht me arsye sikurse në padi.

Paditësi përmes të autorizuarës së tij, duke vepruar sipas aktvendimit të Gjykatës së shkallës së parë, e sipas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit e Kosovës, me parashtrësën e datës 23.12.2019 e ka precizuar kërkesëpadinë ashtu që ka kërkuar që të vërtetohet se paditësi është pronar i parcelës kadastrale nr.225 me kulturë bujqësore e klasës së III në sipërfaqe prej 2699 m², e evidentuar sipas fletëtreguesit nr.59, si dhe ti dorëzohet në posedim faktik sipërfaqja e tokës prej 447 m². Ndërsa me parashtrësën e datës 19.04.2021 e ka precizuar kërkesëpadinë edhe në kuptimin subjektiv ashtu që si i paditur është paraqitur edhe Hajredin Jashari, ndërsa më vonë në vend të tij janë paditur trashëgimtarët e tij, dhe me precizim është kërkuar që ti kthehet paditësit në zotërim faktik paluajtshmëria dhe atë parcela kadastrale ... në sipërfaqe prej 913 m² dhe atë me dimensione nga pika 3 deri te pika 2 në drejtim veri-lindje (338+1,25 m) nga pika 3 deri te pika 4 në gjatësi prej 182,16 dhe gjerësi në anën perëndimore 5,57 m.

E autorizuar e paditësit në seancën e datës 02.09.2021, e ka njoftuar gjykatën që si paditës është paraqitur edhe V.F, pasi që një pjesë e parcelës kadastrale i është shitur të njëjtit, dhe ky paditës është bashkëpronar me paditësin e parë H.F dhe ka interes juridik që ti kthehet në posedim faktik pjesa e ngastrës kadastrale.

Gjykata e shkallës së parë pas pranimit të padisë, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor në të cilin janë administruar provat e parashtruara nga palët ndërgjyqëse, e pas administrimit të tyre ka nxjerrë aktgjykimin, C.nr.725/20, i datës 12.10.2021, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar ka theksuar se pas vlerësimit me kujdes dhe me ndërgjegje të secilës provë veç e veç dhe të gjithave bashkërisht e në pajtim me dispozitat e nenit 8 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, ka gjetur se duhet të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që për Gjykatën e shkallës së parë nuk është kontestuese fakti se paditësit H.F dhe V.F në bazë të fletë treguesit nr.18 të datës 22.07.2021, janë bashkëpronar të parcelës kadastrale nr.K-225-ZK ..., me sipërfaqe të përgjithshme prej 2699

m2, me kulturë bujqësore, kl.3, nr.tabelës 15, dhe atë H.F me pjesën prej 2149/2699 dhe V.F në pjesën prej 550/2699 nga viti 2014, në bazë të kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë të lidhur në mes paditësve LRP.nr.4327/14 ref.nr.1835/2014.

Tutje ka theksuar se nga provat materiale dhe atë ekspertiza gjeodete e ekspertit Samedin Gërxhaliu vërtetohet se një pjesë-sipërfaqe e parcelës kadastrale objekt shqyrtimi, me sipërfaqe prej 913 m2, respektivisht me dimensione nga pika 3 deri në pikën 2 në drejtim veri - lindje (338.1.25 cm), nga pika 3 deri tek pika 4 në gjatësi prej 182,16 m dhe gjerësi në anën perëndimore 5.57 m, shtrihet faktikisht në parcelën kat.nr.K-226 – 0 Z.K Bajskë, e që evidentohet në emër prindit të ndjerë të të paditurve I., N. dhe N.J.1, N.J.1. Ndërsa këtë sipërfaqe e kanë në posedim faktik, të paditurit I., N. dhe N.J.1. Ekspertizën e ekspertit të lartpërmendur gjykata e shkallës së parë ka theksuar se e mori në tërësi si të bazuar dhe i dha besimin e plotë, ngase ekspertiza përmban elementet e nevojshme të dhënë mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsyeve të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoj si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Ndër të tjera në arsyetim theksohet se në përmbajtje të se drejtës pronësore sipas nenit 93 të Ligji nr.03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore ku përcaktohet se: Kërkesa për kthimin e sendit, Pronari mund të kërkoj kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi, hyn edhe e drejta e pronarit që “ta kërkoj kthimin (dorëzimin) e sendit). Andaj në një gjendje të tillë e në kuptim të dispozitës së nenit 93 par.2 të Ligji nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore në të cilin nen në mënyrë decidive thuhet se “Pronari mund të kërkoj kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi, Gjykata e shkallës së parë ka vendos si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se vendosi në pikën IV të këtij aktgjykimi që të refuzoj padinë e paditësve kundër dy të paditurave të para, pasi që me asnjë provë nuk u vërtetua se të njëjtat e kanë në posedim pjesën e paluajtshmërisë objekt shqyrtimi: kthimi faktik i paluajtshmërisë kontestuese, andaj të njëjtat nuk kanë legjitimacion pasiv, për të qenë të paditura - palë procedurale në këtë çështje juridike, ndërsa sa i përket kërkesës së paditësve që të detyrohet e paditura e parë që të bëj bartjen në teren të koordinatave zyrtare të parcelës kadastrale nr.225/Z.K ..., sipas koordinatave nr.1: ... me ..., nr.2: ... ME ..., nr.3: ... me ..., nr.4: ... me ... dhe nr.5: ... me ... ndërsa të detyrohet e paditura Komuna e Vushtrrisë që pas zbatimit të koordinatave të lartcekura në teren, paditësve të ua vejë në posedim dhe shfrytëzim paluajtshmërinë duke e futë në RDPP dhe paditësit të pajisen me Certifikatë të pronësisë dhe skicën e planit me pjesën grafike, gjykata konsideron se procedura e komosacionit ka qenë procedurë administrative, e rregulluar dhe mbikëqyrur nga organet administrative dhe palët e pa kënaqura e kanë pasur mundësinë që brenda afatit të caktuar kohor ta kundërshtojnë këtë proces në procedurë administrative, dhe ka qenë çështje e tyre e vullnetit se janë pajtuar apo jo me punët e përfunduara apo jo nga organet administrative gjatë këtij procesi.

Lidhur me shpenzimet procedurale, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se ka vendosur që të detyrohen të paditurit I.J, N.J dhe N.J.1 që në mënyrë solidare, paditësve të ua paguajnë

shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në lartësi të përgjithshme prej 1904.34 euro, duke u mbështetur në dispozitën nga neni 453.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës nuk e pranon vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar me ankesë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) dhe (o), e lidhur me nenin 160 par. 3 dhe 4 të LPK-së LPK-së, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë si dhe e drejta materiale është zbatuar gabimisht.

Qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurve se, aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182.2 pika n) e LPK-së, sepse dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i pa qartë, kundërthënës dhe në kundërshtim të plotë me arsyetimin, duke mos qenë në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë nuk ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se, qëndrojnë pretendimet ankimore për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës nga neni 182.2 pika o), pasi që është bërë tejkalimi i kërkesëpadsisë sepse nga shikimi i precizimit të kërkesëpadsisë në seancën e datës 02.09.2021, në të cilën e autorizuar e paditësit e ka njoftuar gjykatën që si paditës është paraqitur edhe V.F, pasi që një pjesë e parcelës kadastrale i është shitur të njëjtit, dhe ky paditës është bashkëpronar me paditësin e parë H.F dhe ka interes juridik që ti kthehet në posedim faktik pjesa e ngastrës kadastrale, duke shtuar se, sa i përket kërkesëpadsisë lidhur me sipërfaqen dhe dimensionet që kërkohen në kthim dhe posedim faktik mbetet sikur në precizimin e ushtruar në gjykatë, mirëpo për këtë gjykatë është e paqartë për cilin precizim është fjala dhe është e paqartë nëse ka kërkesë edhe për paditësin e dytë pra nëse është lejuar precizimi i kërkesëpadsisë së paditësve. Kjo gjykatë vëren se, seanca e datës 02.09.2021 nuk është mbajtur, është refuzuar propozimi i të autorizuarës së paditësit që e njëjta të mbahet në mungesë të paditurve Nuredin dhe N. Jashrai, me arsyetimin se nuk janë ftuar në mënyrë të rregullt nga gjykata, ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor nuk mund të vërehet nëse gjykata e ka lejuar apo jo, precizimin sipas deklaramit të të autorizuarës së palës paditëse, pra nuk dihet nëse gjykata ka vendosur lidhur me precizimin e kërkesëpadsisë së paditësve, ndërsa fjala përfundimtare nuk përbën parashtresë me të cilën kërkesëpadsia mund të precizohet.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është po ashtu në kundërshtim edhe me nenin 160.3, dhe 160.4 të LPK-së, ku neni 160.3 parasheh që: *“Dispozitivi i aktgjykimit përmban: vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore, vendimin për ekzistimin apo mosekzistimin e kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesëpadsinë si dhe vendimin mbi shpenzimet procedurale”*, ndërsa neni 160.4 parasheh që: *“Arsyetimi i aktgjykimit përmban kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato”*. Gjykata e Apelit gjen se nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur

me vendosjen sikurse në dispozitiv të aktgjykimit pasi që nuk janë vlerësuar të gjitha faktet vendimtare, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se janë administruar provat mirëpo arsyetimi më tepër përmban thëniet e palëve ndërgjyqëse sesa arsyetim se cilat fakte i ka vërtetuar me anë të provave të administruara.

Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrojnë as pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për faktin se, gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve duke e bazuar në ekspertizën e gjeodezisë të datës 21.11.2019 dhe plotësim ekspertizën e datës 08.02.2021, nga eksperti Samedin Gerxhaliu, gjeodet, si dhe përgjigja në kërkesë e Drejtorisë Gjeodete në Vushtri të datës 22.07.2021. Mirëpo kjo gjykatë vlerëson se, në ekspertizën nga eksperti i gjeodezisë, është konstatuar se, pronar i ngastrës K... e cila gjendet në Z.K. ..., pronar është Hamdi (Osman) Ferizi nga Pasoma me pjesë ideale me 1/1, askund nuk është konstatuar se, në ngastrën lëndore janë bashkëpronar këtu të dy paditësit. Nga përgjigja në kërkesë Referencë 18 nr.38/21 e datës 22.07.2021 drejtuar Gjykatës Themelore në Mitrovicë Dega Vushtri, lidhur me historiatin e ngastrës kadastrale nr.225 ZK ..., nga viti 2010 parcela në fjalë në bazë të Aktvendimit të Komacionit 018K/59 i datës 07.04.2010 kalon në pronësi të Hamdi Osman Ferizi. Nga viti 2014, parcela në fjalë evidentohet si pronë e përbashkët me pjesë ideale 2149/2699 H.F dhe 550/2699 dhe në emër të Veli Kadri Ferati në bazë të kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë LRP nr.4327/2014 ref. 1835/2014. Pra në rastin konkret, ekspertizës i mungojnë provat në të cilat është bazuar, me rastin e konstatimit të pronësisë lidhur me ngastrën që është objekt i shqyrtimit.

Me dispozitën e nenit 356 të LPK-së, është paraparë që: *“Gjykata me propozimin e palëve mund të bëjë të provuarit me anë të ekspertizës, sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijeni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes”*. Ndërsa dispozita e nenit 362 i LPK-së parasheh që: *“Eksperti gjithmonë thirret në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes.”* Në rastin konkret meqenëse pa pasur kundërthënie në mes të ekspertizës së datës 21.11.2019 dhe përgjigjes së datës 22.07.2021, nga e paditura Komuna e Vushtrrisë lidhur me pronësinë e ngastrës lëndore, atëherë e njëjta ka pasur për obligim që të ftoj në seancë ekspertin e gjeodezisë në mënyrë që të jep sqarime shtesë lidhur me ngastrën lëndore, çka një gjë të tillë nuk e ka bërë gjykata e shkallës së parë.

Ekspertiza është mjet provues e cila shfrytëzohet për konstatimin e fakteve për të cilat gjykata nuk ka dije, por e njëjta duhet gjithsesi të punohet në mënyrë profesionale dhe duke u bazuar në prova të cilat gjenden në shkresa të lëndës, krejt kjo me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike.

Për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ka ardhur edhe deri të zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, për këtë arsye është dashur që Aktgjykimi i atakuar të prishët në pikën I, II dhe III (e shënuar si pika IV) e dispozitivit të aktgjykimit dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Në ri procedure gjykata duhet të eliminojë të metat që e kanë shoqëruar aktgjykimin e atakuar ashtu që fillimisht të zbatoj drejtë dispozitat procedurale, të vlerësojë padinë në kuptim të

dispozitave nga neni 99 se a është e qartë dhe e plotë, të vlerësoj parashtresën për precizim të kërkesëpadsisë së paditësit të datës 19.04.2021, si dhe precizimin e padsisë sipas procesverbalit të datës 02.09.2021, të vendos lidhur me precizimin e kërkesëpadsisë së paditësve nëse lejohet apo jo, më pastaj të kërkoj nga eksperti i gjeodezisë të bëjë plotësimin e ekspertizës së gjeodezisë, dhe atë duke u bazuar në provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës, për paluajtshmërinë që është objekt kontesti, duke i dhënë detyra të qarta ekspertit lidhur me historiatin e pronës, përkufizimet dhe sipërfaqen e pjesës së ngastrës lëndore, e më pastaj pas sqarimit të të gjitha rrethanave dhe vlerësimit të të gjitha provave, duke marrë për bazë dhe vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse, të bie vendim të drejtë dhe duke iu përmbajtur elementeve të përcaktuara në nenin 160 të LPK-së.

Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke e lënë të pashqyrtuar pikën IV (e shënuar si pika V) e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar për pjesën tjetër të refuzuar të kërkesëpadsisë së paditësve, në lidhje me të paditurat Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Prishtinë dhe Komunës së Vushtrrisë, pasi që lidhur me këtë pikë nuk kishte pretendim ankimor.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (c) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.9239/2021, me datë 19.07.2024

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj, d.v.